

Duatë nga Kurani dhe suneti

Seid ibn Alij ibn Vehf El-Kahtani

Parathënie

Falënderimi i takon Allahut, Atë e falënderojmë dhe prej Tij falje dhe ndihmë kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje nga Allahu prej të këqijave të vetvetes dhe të veprave tona. Kë e udhëzon Allahu s'ka kush e lajthit dhe kë e largon nga rruga e vërtetë s'ka kush e udhëzon. Dëshmoj se s'ka hyjni tjetër përveç Allahut, i Cili është Një dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i Dërguari i Tij. Paqja dhe Mëshira e Allahut qofshin mbi të, familjen, shokët e tij dhe mbi të gjithë ata të cilët i pasojnë ata me të mira.

Në vijim:

Kjo broshurë është shkurtim nga libri im "edhikru ve duau vel ilaxhu bi ruka minel kitabi ve suneh"¹. Këtu në këtë libër i kam shkurtuar duatë; në mënyrë që një gjë e tillë të jetë më e dobishme,poashtu kam shtuar disa dua dhe dobi tjera të dobishme inshallah teala.

Allahun e Lartësuar e lus me emrat e Tij të bukur si dhe me cilësitë e Tij të larta që këtë vepër ta bën që të jetë thjesht vetëm për Allahun. Paqja dhe Mëshira e Allahut qofshin mbi peygamberin tonë Muhamedin,mbi familjen e tij , shokët e tij në përgjithsi.

Autori

Mbaroi në Shaban 1408 h.

¹ Ky libër që e cekëm elhamdulilah është botuar bashkë me klasifikimin e haditheve në katër vëllime:duatë gjinden në vëllimin e tretë, ndërsa shërimi me rukje gjindet në vëllimin e katërt.

Vlera e duasë

Allahu thotë: **"Zoti juaj ka thënë: Më thirrni Mua, Unë ju përgjigjem, e ata që nga mendjemadhësia i shmangen adhurimit ndaj Meje, do të hyjnë të nënçmuar në xhehennem"**², **"Dhe kur robërit e mi të pyesin ty (o Muhammed) për Mua, atëherë (përgjigju atyre):Vërtet Unë jam pranë, Unë i përgjigjem lutjeve të lutësit kur ai më drejtohet Mua me lutje."**³, i Dërguari i Allahut-paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, ka thënë:*"duaja është ibadet sepse Zoti juaj thotë "më lutni Mua jua pranoj lutjet tuaja"*⁴, poashtu i Dërguari i Allahut-paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *"Zoti juaj i Madhëruar është i Gjallë, Bujar, turpërohet nga robi i Tij, kur i çon duart e tij tia kthen bosh"*⁵. Gjithashtu i Dërguari i Allahut-paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *"Çdo musliman që e lut Allahun me ndonjë lutje, e cila nuk përmban në vete mëkat ose shkëputje të lidhjeve farefisnore, Allahu si shkak i saj do ti dhuron tre gjëra: Ose i përshpejtohet lutja e tij (pra i pranohet) ,ose Allahu ia rruan për në ahiret, ose ia largon një të keqe si ajo". - Të pranishmit thanë: Atherë të lutemi sa më shumë. - Tha:"Allahu jep më shumë"*⁶

Forma e duasë dhe shkaqet e pranimit të saj⁷

- 1-Të jëtë e sinqertë për Allahun.
- 2-Të fillosh me falënderim ndaj Allahut dhe lavdërim ndaj Tij, pastaj duke dërguar salavate mbi Pejgamberin (sal-lallahu alejhi ve sel-lem) si dhe të përfundosh me këtë.
- 3-Kërkimi dhe bindshmëria në pranimin e tyre.
- 4-Insistimi në lutje dhe mosnxitimi.
- 5-Prezenca e zemrës në lutje.
- 6-Lutja të bëhet kur je në begati dhe vështirësi.
- 7-Ta lutësh vetëm Allahun Një.
- 8-Të mos lutet kundër për familjen, pasurinë, fëmijët dhe veten e tij.
- 9-Ulja e zërit gjatë lutjes ndërmjet uljes së zërit dhe shprehjes.
- 10-Pranimi i gabimit dhe kërkimi i faljes për atë, pranimi dhe dëshmia e nimateve (të mirave) dhe falënderimi i Allahut për to.
- 11-Mos ta tepron në lutje në rritm proze.
- 12-Këmbëngulja, përultësia, shpëtimi dhe strehimi.
- 13-Tu kërkon falje atyre që ju ka bërë zullum(padrejtësi), duke ia bashkangjitur asaj pendimin.
- 14-Lutja të bëhet tre herë.
- 15-Drejtimi kah Kibla.
- 16-Ngritja e duarve gjatë duasë.
- 17-Marrja abdest para duasë po që se i lehtësohet një gjë e tillë.

² Suretu Gafir,ajeti:60.

³ Suretul-Bekare,ajeti:186.

⁴ Ebu Davudi 2/78, Tirmidhiu 5/211, ibn Maxheh 2/1258, shiko në "sahihul xhami esagir" 3/150, sahih ibn Maxheh 2/324.

⁵ Ebu Davudi 2/78, Tirmidhiu 5/557, ibn Maxheh 2/1271, ibn Haxheri thotë:zinxhiri i hadithit është i mirë.Shiko në sahihu Tirmidhi 3/179.

⁶ Tirmidhiu 5/566,5/462, Ahmedi 3/18, shiko sahihul xhami 5/116, sahihu Tirmidhi 3/140.

⁷ Shiko formën dhe shkaqet e pranimit të duasë me argumente në origjinën e librit fq.88 deri në 121.

18-Të mos e tepron në dua.

19-Lutësi të fillojë të lutet për vete, para se të lutet për tjerët në qoftë se lutet për dikënd tjetër.⁸

20-Ta lusë Allahun me emrat e Tij të bukur dhe cilësitë e Tij të larta, ose me ndonjë vepër të mirë që e ka bërë, apo me duanë e ndonjë personi të mirë që është gjallë dhe prezent tek ai.

21-Ushqimi, pirja dhe veshja e tij të jenë hallall.

22-Të mos lutet për të bërë mëkat, apo për ti ndërprerë lidhjet farefisnore.

23-Të urdhëroj për të mirë dhe të ndalon nga e keqja.

24-Të largohet nga të gjitha mëkatet.

Kohërat, rastet dhe vendet kur pranohet duaja:⁹

1-Natën e Kadrit.

2-Në thellësinë e natës.

3-Pas namazeve farze.

4-Mes ezanit dhe ikametit.

5-Një orë prej çdo nate (pjesa e tretë e natës).

6-Kur thirret ezani për namazet farze.

7-Kur të bie shi.

8-Kur përballen muslimanët me armikun në rrugë të Allahut.

9-Një orë gjatë ditë së Xhuma.

Thënia më e vërtetë që flet për vlerën e kësaj kohe është se ajo orë është ora e fundit prej kohës të ikindisë deri në kohën e akshamit, ose mund të jetë në orën kur mbahet hutbeja ose në namaz.

10-Gjatë pirjes së ujit Zemzem me nijet (qëllim) të sinqertë.

11-Në sexhde.

12-Kur të çohesh natën prej gjumi,duke u lutur me duatë që transmetohen në këtë kontekst.

13-Nëse ke fjetur me abdest pastaj je ngritur natën dhe je lutur.

14-Gjatë lutjes me fjalën (La ilahe il-la ente subhaneke ini kuntu minedh-dhalimin).

15-Lutja e njerëzve për njeriun që është në momentet e fundit të jetës.

16-Lutja pas falënderimit të Allahut dhe salavateve mbi Pejgamberin alejhi selam gjatë teshehudit të fundit në namaz.

17-Gjatë lutjes së Allahut me emrin e Tij të Madh, me të cilin emër poqëse i lutesh me të Allahut,të përgjigjet dhe nëse kërkohet diç prej Tij të jep.¹⁰

18-Lutja e muslimanit për vëllaun e tij musliman në mosprezencën e tij.

19-Lutja ditën e Arafatit në Arafat.

20-Lutja në muajin e Ramazanit.

21-Gjatë mbledhjes së muslimanëve në ndenjat e dhikrit (përmendjes së Allahut).

22-Lutja në fatkeqësi me "Ina lilahi ve ina ilejhi raxhiun, Allahume exhurni fi musibeti ve hluf li hajran minha"(Të Allahut jemi dhe tek ai do të kthehemi,O Allah më shpërble për këtë fatkeqësi dhe ma kompenzo këtë sprovë me një më të mirë se atë që kisha).

⁸ Përcillet në hadithe të sakta se i Dërguari i Allahut salallahu alejhi ve selem kur është lutur ka filluar me vetveten e tij në fillim, njëashtu përcillet se ai në disa raste nuk ka filluar me veten e tij siç është rasti kur bëri dua për Enesin,ibn Abasin, umu Ismailin e të tjerë.Për më shumë shiko në : sherh sahihul Muslim të Neveviut 15/144, tuhfetul ahfedhi sherh sahihu Tirmidhij 9/328, Buhariu meal fet-h 1/218.

⁹ Shiko këto kohra,gjendje,vende me argumente në detaje në origjinalin e këtij libri fq:101-118.

¹⁰ Shiko në:ismullahil adham në hadithin nr:94,95,96 të këtij libri.

- 23-Duaja ndaj Allahut me sinqeritet të madh.
- 24-Lutja e atij që i është bërë padrejtësi ndaj zullumqarit (ai që i ka bërë padrejtësi).
- 25-Lutja e prindit për fëmiun e tij dhe për prindërit e tij.
- 26-Lutja e udhëtarit.
- 27-Lutja e agjëruesit derisa të bëj iftar.
- 28-Lutja e agjëruesit gjatë kohës së iftarit.
- 29-Duaja e atij që është në zort.
- 30-Duaja e imamit(udhëheqësit) të drejtë.
- 31-Lutja e fëmiut të ndershëm për prindërit e tij.
- 32-Duaja pas abdestit pasi i thotë duatë që përcillen nga Pejgamberi salallahu alejhi ve selem.
- 33-Lutja pas gjuajtjes së gurëve tek Xhemerati i vogël.
- 34-Lutja pas gjuajtjes së gurëve tek Xhemerati i mesëm.
- 35-Duaja brenda Qabes, andaj kush falet në hixhr¹¹ kjo llogaritet pjesë e Qabes.
- 36-Lutja në Safa.
- 37-Lutja në Merva.
- 38-Lutja tek Mesharil-Harami(Muzdelife).

Besimtari i vërtet e lut Zotin e tij çdoherë kudo që të jetë” ***Dhe kur robërit e mi të pyesin ty (o Muhammed) për Mua, atëherë (përgjigju atyre):"Vërtet Unë jam pranë, Unë i përgjigjem lutjeve të lutësit kur ai më drejtohet Mua me lutje."***¹², mirëpo këto kohra,raste,vende që i cekëm duhet të veçohen më shumë me dua.

¹¹ Vendi rreth i cili gjindet ngjitur me Qaben.

¹² Suretul-Bekare,ajeti:186.

Duatë nga Kurani dhe suneti

A - Duatë nga Kurani

Falenderimi i takon Allahut bekimet,paqa e Allahut qofshin mbi Pejgamberin,pas të cilit nuk ka më pejgamber pas tij.

1-"**Zoti ynë, ne i bëmë të padrejtësi (dëmtuam) vetvetes sonë, në qoftë se nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne me siguri do të jemi prej të shkatërruarve!**"¹³.

2-"**Zoti im, unë mbështetem në mbrojtjen Tënde që të (mos) kërkoj prej Teje atë për çka nuk kam njohuri, e në qoftë se nuk më fal mua dhe nuk më mëshiron Ti, do të jem prej të humburve!**"¹⁴.

3-"**Zoti im, më fal mua dhe prindërit e mi, dhe ata që hynë në shtëpinë time, duke qenë besimtarë, edhe besimtarët e besimtare!**"¹⁵.

4-"**Zoti ynë, pranoje prej nesh, se me të vërtetë Ti je që dëgjon dhe di".**

"Dhe falna neve, vërtet Ti je që fal shumë, je Mëshirues!".¹⁶

5-"**O Zoti im! Më bën mua nga ata që falin namazin, e edhe pasardhësit e mi dhe pranoje lutjen time, o Zoti ynë.**"¹⁷

6-"**Zoti ynë! Më fal (gabimet) mua edhe prindërve të mi, fali edhe të gjithë besimtarët ditën kur jepet llogaria.**"¹⁸

7-"**Zoti im, më dhuro mua urtësi dhe më bashko me të mirët! Më bën përkujtim të mirë ndër ata që vijnë pas, Më bën prej trashëguesve të Xhenetit të begatshëm."**

"O Zot bërë të mos pikëllohem në ditën e rringjalljes"¹⁹

8-"**Zoti im, më dhuro mua (një fëmijë) prej të mirëve!**"²⁰

9-"**Zoti ynë, vetëm Ty të jemi mbështetur, vetëm nga Ti jemi të kthyer dhe vetëm te Ti është e ardhmja!**"²¹

10-"**Zoti ynë, mos na bën sprovë në duar të atyre që nuk besuan dhe falna, Zoti ynë, Ti je Ngadhënjyesi, i Urti.**"²²

11-"**Zoti im, më mundëso që t'i falënderoj të mirat Tuaja që m'i dhurove mua dhe prindërve të mi dhe që të bëj vepra të mira që Ti i pëlqen, e me mëshirën Tënde më fut në mesin e robërve Tuaj të mirë!**"²³

12-"**Zoti im, më fal edhe mua nga ana Juaj një pasardhës (fëmijë) të mirë, vërtet, Ti je dëgjues i lutjes!**"²⁴.

13-"**Zoti im, mos më lë të vetmuar se Ti je më i miri trashëgues (pas çdokujt).**"²⁵

14-"**Nuk ka Zot pos Teje. Ti je i pastër, nuk ke të meta. Unë i bëra padrejtë vetes!**"²⁶.

¹³ Suretul-Araf,ajeti:23.

¹⁴ Suretu Hud,ajeti:47.

¹⁵ Suretu Nuh,ajeti:28.

¹⁶ Suretul-Bekare,ajetet:127-128.

¹⁷ Suretu Ibrahim,ajeti:40.

¹⁸ Suretu Ibrahim,ajeti:41.

¹⁹ Suretu Shuara,ajetet:83-85,87.

²⁰ Suretu Safat,ajeti:100.

²¹ Suretul-Mumtehine,ajeti:4.

²² Suretul Neml,ajeti:19.

²³ Suretu Neml,ajeti:19.

²⁴ Suretu Ali-Imran,ajeti:38.

²⁵ Suretu El-embija,ajeti:89.

²⁶ Suretu El-embija,ajeti:87.

15-**"Ma zgjero (më ndihmo) gjoksin tim! Dhe më lehtëso në këtë punë timen! Ma zgjidh nyjen e gjuhës sime! Që ta kuptojnë fjalën time!"**²⁷.

16-**"Zoti im, unë e ngarkova veten e Ti më fal mua!"**²⁸.

17-**"Zoti ynë, ne besuam atë që e zbritte (shpalljen), e pasuam të Dërguarin (Isain), pra shënona bashkë me ata që dëshmojnë (besimin e drejtë!"**²⁹

18- **"Zoti ynë, mos i mundëso popullit mizor të na sprovovë! Dhe me mëshirën tënde, na shpëto prej popullit jobesimtar"**³⁰

19-**"Zoti ynë, na i fal mëkatet tona dhe lëshimet në punët tona dhe na forco në vendet tona (në luftë), ndihmona kundër popullit pabesimtar!"**³¹.

20-**"O Zoti ynë, na dhuro nga ana Jote mëshirë dhe na përgatit udhëzim të drejtë në tërë çështjen tonë!"**³².

21-**"Zoti im, më shto dituri!"**³³.

22-**"O Zot i im, unë mbrohem me Ty prej cytjeve të djajve!" Dhe mbështetem te Ti që ata të mos më afrohen!"**³⁴.

23-**"O Zoti im, më fal e më mëshiro, se Ti je më Mëshiruesi i mëshiruesve!"**³⁵.

24-**"Zoti ynë na jep të mira në këtë jetë, të mira edhe në botën tjetër dhe na ruaj prej dënimit me zjarr!"**³⁶.

25-**"Iu përgjigjëm thirrjes dhe respektuam urdhërin. Kërkojmë faljen tënde o Zoti ynë! Vetëm te Ti është ardhmëria jonë"**³⁷

26-**"Zoti ynë, mos na dëno nëse harrojmë ose gabojmë! Zoti ynë, mos na ngarko neve barrë të rëndë siç i ngarkove ata që ishin para nesh! Zoti ynë, mos na ngarko me atë për të cilën ne nuk kemi fuqi! Na i shlyej mëkatet, na i mbulo të këqijat, na mëshiro. Ti je mbrojtësi ynë, na ndihmo kundër popullit pabesimtar!"**³⁸.

27-**"Zoti ynë, mos na i lako zemrat tona pasi na drejtove, na dhuro mëshirën Tënde, sepse vetëm Ti je Dhuruesi i madh."**³⁹

28-**"Zoti ynë, këtë nuk e krijove kot, i lartësuar qofsh, ruana prej dënimit të zjarrit! Zoti ynë, atë që Ti e fute në zjarr, atë e ke poshtëruar; për mizorët nuk ka ndihmëtarë! Zoti ynë, ne dëgjuam një thirrës që ftonte për besim (e që thoshte): Të besoni Zotin tuaj! E ne besuam! Zoti ynë, na i fal mëkatet tona, na i mbulo të metat dhe pas vdekjes na bashko me të mirët! Zoti ynë, jepna atë që nëpërmjet të dërguarëve Tu, na e premtove dhe në Ditën e Kijametit mos na turpëro; vërtet Ti je Ai që nuk e shkel premtimin!"**⁴⁰

29-**"O Zoti ynë, ne besuam, prandaj na fal dhe na mëshiro, se Ti je më i Miri i mëshiruesve!"**⁴¹.

30-**"Zoti ynë, largoje prej nesh vuajtjen e Xhehenemit, e s'ka dyshim se vuajtja në të është gjëja më e rëndë. Dënimi xhehenemit është vendëstrehim dhe vend shumë i keq"**⁴².

²⁷ Suretu Taha, ajetet: 25-28.

²⁸ Suretu-Kasas, ajeti: 16.

²⁹ Suretu Ali-Imran, ajeti: 53.

³⁰ Suretu Junus, ajeti: 85, 86.

³¹ Suretu Ali-Imran, ajeti: 147.

³² Suretul-Kehf, ajeti: 10.

³³ Suretu Taha, ajeti: 114.

³⁴ Suretul-Muminun, ajetet: 97-98.

³⁵ Suretul-Muminun, ajeti: 118.

³⁶ Suretul-Bekare, ajeti: 201.

³⁷ Suretul-Bekare, ajeti: 285.

³⁸ Suretul-Bekare, ajeti: 286.

³⁹ Suretu Ali-Imran, ajeti: 8.

⁴⁰ Suretu Ali-Imran, ajeti: 191-194.

⁴¹ Suretul-Muminun, ajeti: 109.

31-"Zoti ynë, na bën që të jemi të gëzuar me (punën) e grave tona dhe pasardhësve tanë, e neve na bën shembull për të devotshmit."⁴³

32-"Zoti im, më inspiro mua që të falënderoj për të mirën Tënde që ma dhurove mua dhe prindërve të mi, që të bëj vepra të mira që i pëlqen Ti dhe m'i bën të mirë pasardhësit e mij, unë pendohem te Ti dhe unë jam me muslimanët."⁴⁴

33-"Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë që para nesh u pajisën me besim dhe mos lejo në zemrat tona farë urrejtjeje ndaj atyre që besuan. Zoti ynë Ti je i butë, mëshirues!"⁴⁵.

34-"Zoti ynë, vazhdona dritën tonë, falna neve. Vërtet, Ti je i plotfuqishëm për çdo send."⁴⁶

35-"Zoti ynë, ne besuam sinqerisht, na i fal mëkatet tona na ruaj prej ndëshkimit të zjarrit!"⁴⁷

36-"Zoti ynë, ne kemi besuar, pra na regjistron ndër ata që dëshmojnë (ndër umetin e Muhammedit)."⁴⁸

37-"Zoti im! Bëje këtë qytet të sigurt dhe më mbro mua e bijtë e mi nga adhurimi i idhujve (statuja gurësh)."⁴⁹

38-"O Zoti im, unë kam nevojë për çkado që të më japësh!"⁵⁰

39-"O Zoti im, më ndihmo kundër popullit të prishur!"⁵¹

40-"Zoti ynë, mos na bë neve me mizorët!"⁵²

41-"Allahu është për mua mjaft, s'ka të adhuroar pos Tij, vetëm tek Ai jam mbështetur, e Ai është Zot i Arshit të madh!"⁵³

42-"Shpresoj që Zoti im të më orientojë rrugës së drejtë".⁵⁴

43-"O Zoti im, më shpëto prej popullit zullumqar!"⁵⁵

B – Duatë nga suneti

44 - "O Allah na jep të mira në dunja dhe në ahiret,si dhe na mbroj nga dënimi i zjarrit".⁵⁶

45 - "O Allah kërkoj mbrojtje me Ty nga sprova e zjarrit,dënimi i zjarrit,dënimi i varrit,sprovës së varrit,dënimit të varrit,nga sherri i provës së pasurisë,si dhe nga sherri i provës se fukarallëkut. O Allah kërkoj mbrojtje me Ty nga sprova e Mesihu-Dexhallit,o Allah pastroe zemrën time me ujë akull dhe të ftohtë,pastroe zemrën time nga mëkatet siç e pastron teshën e bardhë nga ndytyësira,largoi mëkatet e mia larg meje siç e ke bërë larg

42 Suretul-Furkan,ajetet:65,66.

43 Suretul-Furkan,ajeti: 74.

44 Suretul-Ahkaf,ajeti: 15.

45 Suretul-Hashr,ajeti:10.

46 Suretu Tahrim,ajeti:8.

47 Suretu Ali-Imran,ajeti: 16.

48 Suretul-Maide,ajeti:83.

49 Suretu Ibrahim,ajeti:35.

50 Suretul-Kasas,ajeti:24.

51 Suretul-Ankebut,ajeti:30.

52 Suretul-Araf,ajeti: 47.

53 Suretu-Teube,ajeti:129.

54 Suretul-Kasas,ajeti:22.

55 Suretul-Kasas,ajeti:21.

56 Buhariu 7/163,Muslimi 4/2070.

lindjen nga perendimi. O Allah kërkoi mbrojtje me Ty nga dembelia, kërkoi mbrojtjen Tënde nga mëkatet dhe borxhet (ndaj njerëzve)".⁵⁷

46 - *"O Allah kërkoi mbrojtje prej Teje nga pamundësia, dembelia, frika ,pleqëria ,koprracia, si dhe kërkoi mbrojtje nga Ty prej dënimi i varrit, si dhe nga sprovat e jetës dhe vdekjes".⁵⁸*

47 -

48 - *"O Zot ma përmirso fenë time, e cila është strehimi i çështjes time, ma përmirëso këtë dunja në të cilën jetoj, ma përmirëso ahiretin në të cilën është kthimi im, dhe ma shto jetën në çdo të mirë dhe më bëj vdekjen të rehatshme nga çdo e keqe".⁵⁹*

49 - *"O Zot, unë të kërkoi Ty udhëzim, devotshmëri, falje dhe pasuri".⁶⁰*

50 - *"O Allah kërkoi mbrojtje nga Ty prej : pamundësisë, dembelisë, frikës, kopracisë, pleqërisë si dhe dënimit të varrit, o Allah jepi shpirtit tim devotshmëri, pastroje atë sepse Ti je pastruesi më i mirë. Ti je kujdestarë i saj, si dhe mbikqyrësi i saj. O Allah kërkoi mbrojtje nga Ty prej diturësë e cila nuk të bën dobi, prej zemrës e cila nuk të frigohet Ty, prej trupit i cili nuk ngopet, si dhe prej duasë e cila nuk pranohet".⁶¹*

51 - *"O Allah më udhëzo, më drejto në rrugën e drejtë, o Allah prej Teje e kërkoi udhëzimin dhe rrugën e drejtë".⁶²*

52 - *"O Allah kërkoi mbrojtje prej Teje nga humbja e mirësive, humbja e shëndetit, nga largimi i mbrojtjes Tënde, nga befasia e dënimit Tënd dhe nga i gjithë hidhërimi Yt".*

53 - *"O Allah unë kërkoi mbrojtje prej Teje nga sherri i asaj që kam vepruar dhe nga sherri i asaj që nuk e kam vepruar".⁶³*

54 - *"O Allah ma shto pasurinë time, fëmijët e mi, më begato në atë që ma ke dhuruar"⁶⁴ (ma zgjat jetën time në respekt ndaj Teje, përmirëso veprat e mija) dhe më fal mua"⁶⁵.*

55 - *"S'ka zot tjetër përveç Allahut më të madhit, me të urtit, nuk ka zot përveç Allahut, Zotit të arshit të madh, nuk ka zot tjetër përveç Allahut, Zoti qiejve Zot i tokës dhe Zoti i arshit fisnik".⁶⁶*

56 - *"O Allah pres mëshirën tënde, mos më le të mbështetem në veten time as sa një hap dhe mbyllje të syve, mi përmirëso mua të gjitha çështjet e mia, nuk ka zot tjetër pos teje".⁶⁷*

⁵⁷ Buhariu 7/161, Muslimi 4/2078.

⁵⁸ Buhariu 7/59, Muslimi 4/2079.

⁵⁹ Muslimi 4/2087.

⁶⁰ Muslimi 4/2087.

⁶¹ Muslimi 4/2088.

⁶² Muslimi 4/2090.

⁶³ Transmeton Muslimi 4/2085

⁶⁴ Për këtë aludon dua ja e të Dërguarit të Allahut-paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, drejtuar Enesit -Allahu qoftë i kënaqur me të, duke thënë: "O Allah shtoja atij pasurinë e tij, fëmijët e tij dhe jepi bereqet (begatoje) me atë që ia ke dhuruar", transmeton Buhariu 7/154, Muslimi 4/198

⁶⁵ Transmeton Buhariu në "Edebul mufred" nr. 653, Albani hadithin e saktëson në "Silsiletu ehaditha sahiha" nr. 2241 në "Sahih edebul-mufred" fq. 244, fjala ndërmjet dy kllapave aludon në fjalën e të Dërguarit të Allahut-paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, kur pyet: Kush është njeriu më mi mirë? – Ai tha: "Njeriu i cili jeton gjatë dhe bën vepra të mira". Transmeton Tirmidhiu, Ahmed, Albani e saktëson hadithin në "Sahih Tirmidhi" 2/271, shejh Ibn Bazin e kam pyetur se a është sunet të bësh dua me këtë fjalë, më ka thënë se po është.

⁶⁶ Transmeton Buhariu 7/154, Muslimi 4/2092

⁶⁷ Transmeton Ebu Davudi 4/324, Ahmedi 5/42, Albani hadithin e bën të mirë e të tjerë pos tij

57 – *"Nuk ka zot tjetër pos Teje, i pa të meta je ti unë i kam bërë padrejtësi vetes time".⁶⁸*

58 – *"O Zoti im, unë jam robi Yt e biri i robit Tënd dhe i robreshës Sate, balli im është në dorën Tënde, dispozitat Tuaja mbi mua i pranoj, i drejtë është gjykimi Yt mbi mua. Të lutem me çdo emër me të cilin e ke emëruar Vetën Tënde ose që e ke zbritur në librin Tënd apo ia ke mësuar dikujt prej krijesave Tua, apo që e ke mbajtur të fshehur në diturinë Tënde, bëre Kuranin pranverë të zemrës sime dhe dritë të gjoksit tim, shëndritje për pikëllimin dhe largim për dëshmpërimin".⁶⁹*

59 – *"O Allah o rrotulluesi i zemrave, rrotulloi zemrat tona në respekt ndaj Teje".⁷⁰*

60 – *"O ndryshues i zemrave, përforcoje zemrën timë në fenë Tënde".⁷¹*

61 – *"O Allah më jep mua shpëtim në dunja dhe në ahiret".⁷²*

62 – *"O Allah na e bën përfundimin tonë të çdo gjëje të mirë na ruaj nga poshtrimi në dunja dhe dënimi në ahiret".⁷³*

63 – *"O Zot më ndihmo mua, e mos kundër mua, më ndihmo mua e mos kundër mua, lëshoi belatë mbi armiqtë e mi e jo mbi mua, më udhëzo mua, ma bën të lehtë udhëzimin, më ndihmo mua ndaj atij që e tepron kundër meje, o Zot më bën të jem falenderues ndaj Teje, përkujtues i Yti, të friksohem vetëm nga Ti, të të nënshtrohem vetëm Ty, të të respektoj vetëm Ty, të të dorëzohem vetëm Ty, o Zot pranoje pendimin tim, mi laj mëkatet e mia, pranoi lutjet e mia, më forco mua në dunja dhe në varr, udhëzoje zemrën time, gjuhën time bërë të flas çdo herë ku duhet, nxire zilin nga zemra ime".⁷⁴*

64 – *"O Allah prej Teje kërkojmë atë çfarë e ka kërkuar i Dërguari Yt Muhamedi, kërkojmë mbrojtje prej Teje nga sherri i asaj që ka kërkuar mbrojtje nga ajo i Dërguari Yt Muhamedi, Ti je Ai nga i Cili kërkohet ndihmë, Ty të takon kumtimi, nuk ka forcë dhe lëvizje pa lejen tënde".⁷⁵*

65 – *"O Allah prej Teje kërkoj të më mbrosh nga sherri i dëgjimit tim, nga sherri i shikimit tim, nga sherri i gjuhës time, nga sherri i zemrës time, nga sherri i vdekjes sime".⁷⁶*

66 – *"O Allah më mbroj mua nga lebrosa, çmenduria, amputacioni dhe nga sëmundjet e këqija".⁷⁷*

⁶⁸ Transmeton Tirmidhiu 5/295, Hakimi i cili e saktëson hadithin me të pajtohet edhe Dhehebiu 1/505, shiko "Sahih Tirmidhi" 3/168, teksti i tij është: *"Duaja e Dhenunit (Junusit) kur u lut në barkun e balenës ishte: Nuk ka Zot tjetër pos Teje, i pa të meta je unë i bëra padrejtësi vetes sime, çdo besimtarë që e lut Allahun me këtë dua Ai i pranon atë"*.

⁶⁹ Transmeton Ahmedi 1/391, 452, Hakimi 1/509, Hafidhi e bën hadithin të saktë në "Tehrixhul-edhkar" Albani e saktëson shiko "Tahrixhul kelimu tajib" fq. 73

⁷⁰ Transmeton Muslimi 4/2045

⁷¹ Transmeton Tirmidhiu 5/538, Ahmedi 4/182, Hakimi 1/525, 528, i cili hadithin e saktëson, e me të pajtohet edhe Dhehebiu, shiko "Sahihul xhami" 6/309, "Sahih Tirmidhi" 3/171, Umu Seleme-Allahu qoftë i kënaqur me të, thotë: Kjo ishte duaja e shpeshtë e Tij.

⁷² Transmeton Tirmidhiu 5/534, e të tjerë pos tij, teksti i tij është: *"Lutëni Allahun për në dunja dhe në ahiret"* kurse në një transmetim tjetër: *"Lutëni Allahut tua fal mëkatet dhe për shëndet ngase dikujt prej jush pas bindjes nuk i jepet diçka më e mirë se shëndeti"*. Shiko "Sahihul Tirmidhi" 3/180, 3/185, 3/170, hadithi po ashtu posedon dëshmi – shevaid, për më shumë shiko "Musned" imam Ahmedi më rënditjen e Ahmed Shakirit 1/156-157.

⁷³ Transmeton Ahmedi 4/181, Taberaniu në "El-kebir" Hafidh el-Hejthemiu në "Mexhmetu zevaid" 10/178 thotë: Transmetuesit e Ahmedit dhe njëri nga zinxhirit e Taberaniut janë të besueshëm.

⁷⁴ Transmeton Ebu Davudi 2/83, Tirmidhiu 5/554, Ibn Maxhe 2/1250, Hakimi i cili hadithin e saktëson, me të pajtohet edhe Dhehebiu 1/519, shiko "Sahihu Tirmidhi" 3/178, Ahmedi 1/127.

⁷⁵ Transmeton Tirmidhiu 5/537, Ibn Maxhe 2/1264, me të njëjtin kuptim.

⁷⁶ Transmeton Ebu Davudi 2/92, Tirmidhiu 5/523, Nesaiu 8/271 e të tjerë, shiko "Sahihu Tirmidhi" 3/166, "Sahih Nesai" 3/1108.

67 – *"O Allah kërkoj mbrotje prej Teje nga veset e këqija morale, punët e këqija dhe epshet".*⁷⁸

68 – *"O Allah Ti me të vërtet je falës i madh Bujar, e don faljen të lutem më fal mua".*⁷⁹

69 – *"O Allah prej Teje kërkoj të më mundëson të bëjë punë të mira, të largohem nga punët e këqija, ti dua të varfurit, me fal mua, më mëshiro dhe kur të duash ta sprovosh një popull mua me vdis e mos më kaplo me atë sprovë, kërkoj dashurinë Tënde, dashurinë e atyre që të duan Ty, dashurinë e çdo vepre që më afron tek dashuria Yte".*⁸⁰

70 – *"O Allah kërkoj prej Teje çdo hajr për të tashmen dhe të ardhmen, atë që e di nga ato dhe atë që nuk e di nga ato, kërkoj mbrotje prej Teje prej çdo sherri të çdo gjëje të tashmes dhe të ardhmes prej asaj që e di dhe që nuk e di. O Allah kërkoj prej Teje të mirat që i ka kërkuar robi yt dhe profeti yt, po ashtu kërkoj mbrotje prej Teje nga sherri (me atë që ka kërkuar strehim) (prej saj) robi Yt dhe profeti Yt, o Allah prej Teje kërkojë xhenetin si dhe çdo vepër dhe fjalë që më afron tek ai, kërkoj mbrotje prej Teje nga zjarri dhe çdo vepër dhe punë që më afron tek ai, kërkoj prej Teje që çdo gjë që ke caktuar mbi mua ta bësh hajr për mua".*⁸¹

71 – *"O Allah me ruaj të qëndroj në islam, më forco me islam, më bën të qëndroj në islam, më bën të jem në islam i qëndrueshëm, mos e kënaq armikun e as ziliqarin me belanë time. O Allah kërkoj prej Teje çdo të mirë që është në dorë të thesarit Tënd, kërkoj mbrotje prej Teje nga çdo e keqe që e kë në dorën tënde".*⁸²

72 – *"O Allah na dhuro frikë prej Teje e cila do të na mbrojë nga mëkatet ndaj Teje, respekt ndaj Teje e cila do të na çon në xhenet, bindje ndaj Teje e cila do të na i lehtëson fatkeqësitë e kësaj bote, o Allah na e kënaq dëgjimin tonë, shikimin tonë, forcën tonë sa të jemi gjallë, pastaj trashëgoje tek pasardhësit tonë, hakmeru mbi ne me ata që na kanë bërë zullum, na ndihmo kundër atyre që na armiqësojnë mos na sprovon në fe, mos na e bën dunjanë qëllimin më të madh tonin, e as qëllim të dijës tonë, mos na e bën të na sundojnë ata që nuk na mëshirojnë".*⁸³

73 – *"O Allah kërkoj mbrotje prej Teje nga ligështia, kopracia, matufosja, fitneja e kësaj bote dhe dënimi i varrit".*⁸⁴

74 – *"O Allah fale mëkatin tim, injorancën time, teprimin tim, atë që e din për mua, o Allah më fal mua atë mëkat që e bëjë rëshqitasi dhe seriozisht, mëkatin që e bëj nga haresa dhe qëllimisht, të gjitha këta unë i posedoj".*⁸⁵

⁷⁷ Transmeton Ebu Davudi 2/93, Nesaiu 8/271, Ahmedi 3/192, shiko "Sahihu Nesai" 3/1116, "Sahih Tirmidhij" 3/184.

⁷⁸ Transmeton Tirmidhiu 5/575, Ibn Hibani, Hakimi, Taberaniu, shiko "Sahih Tirmidhij" 3/184.

⁷⁹ Transmeton Tirmidhiu 5/534, me recensim të Ibrahim Adevij, botim i Mustafa el-Babij, shiko "Sahih Tirmidhij" 3/170.

⁸⁰ Transmeton Ahmedi me këtë tekst 5/243, Tirmidhiu ngajshëm me të 5/369, Hakimi 1/521, Tirmidhiu hadithin e bën të mirë dhe thotë: E kam pyetur Muhamed ibn Ismailin, pra Buhariun, më tha: Ky hadith është hasenu-sahih, në fund të hadithit qëndron se ai-paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: "Kjo është realitet mësonje dhe mësojani të tjerëve".

⁸¹ Transmeton Ibn Maxhe 2/1264, Ahmedi 6/134, shtojca e dytë e tekstit është i tij, Hakimi, i cili e saktëson hadithin me të pajtohet edhe Dhehebiu 1/521, shtojca e parë e tekstit është i tij, shiko "Sahih Ibn Maxhe" 2/327.

⁸² Transmeton Hakimi 1/525 i cili hadithin e saktëson e me të pajtohet edhe Dhehebiu, shiko "Sahihul-xhami" 2/398, "Silsiletu ehadithu sahiha" 4/54 nr. 1540.

⁸³ Transmeton Tirmidhiu 5/528, Hakimi 1/258, i cili e saktëson hadithin e me të pajtohet edhe Dhehebiu, Ibn Sinij nr. 446, shiko "Sahihu Tirmidhij" 3/168, "Sahihul-xhami" 1/400.

⁸⁴ Transmeton Buhariun në "Meal fet'h" 11/181.

75 – “O Allah unë i kam bërë vetes sime padrejtësi të madhe, e nuk ka kush fal mëkatet pos Teje, më fal mua me faljen Tënde, më mëshiro mua sepse Ti je Gjithëfalësi, Gjithëmëshiruesi”.⁸⁶

76 – “O Allah Ty të jam dorëzuar, Ty të kam besuar, Ty të ja mbështetur, tek Ti kthehem, për Ty armiqësoj, o Allah të lutem Ty me krenarinë Tënde nuk ka Zot tjetër pos Teje, mos më devijoj, Ti je i Gjalli i Cilli nuk vdes ndërsa xhinët dhe njerëzit vdesin”.⁸⁷

77 – “O Allah prej Teje kërkoj shkaqet e mëshirës Tënde, synimet të falje Tënde, na ruaj nga çdo mëkat, na jep çdo mirësi, na shpëto me xhenet dhe na shpëto nga zjarri i xhehenemit”.⁸⁸

78 – “O Allah më jep rrizk të gjërë kur të plakem dhe pak para përfundimit të jetës sime”.⁸⁹

79 – “O Allah ma fal mua mëkatin, më zgjero në shtëpinë time, e me begato në rrishtun tim”.⁹⁰

80 – “O Allah kërkoj prej mirësisë dhe mëshirës Tënde, sepse atë nuk e posedon askush pos Teje”.⁹¹

81 – “O Allah më mbroj nga pavendosshmëria, shembja, fundosja, djegja, o Allah më mbroj nga tronditjet e shejtanit gjatë vdekjes, më mbroj mos vdes duke ia kthyer shpinën armikunt në luftë, më mbroj mos vdes i helmuar”.⁹²

82 – “O Allah më mbroj nga uria ngase ajo është shtrirja më e keqe, më mbro nga tradhëtia ngase ajo është bashkpunimi më i keq”.⁹³

83 – “O Allah më mbroj nga pamundësia, përtacia, friksimi, kopracia, pelqëria, vrazhdësia, pakujdesia, varfëria, poshtrimi, mospasja, më mbroj nga fukarallëku, kufri, mëkati, përçarja, dyftyrësia, syfaqësia, mburja me veten, më mbro nga të shurdhëruarit, memecllëku, çmenduria, këputja e pjesëve të trupit, lebroza dhe sëmundjet e këqija”.

84 – “O Allah më ruaj nga fukarallëku, mospasja, poshtrimi, më mbroj që ti bëj dikujt padrejtësi apo të më bën dikush padrejtësi”.⁹⁴

85 – “O Allah më mbroj nga fqiu i keq në nëpër shtëpia të lokalizuara ngase fqiu beduin transferohet”.⁹⁵

86 – “O Allah më ruaj nga zemra jo e devotshme, nga duaja që nuk pranohet, nga trupi i pa ngirë, nga dija e padobishme, më mbro nga këta katër gjëra”.⁹⁶

87 – “O Allah më ruaj nga dita e keqe, nga nata e keqe, nga ora e keqe, nga shoku i keq, nga fqiu i keq nëpër shtëpi të banuara lokale”.⁹⁷

⁸⁵ Transmeton Buhariu në “Meal fet'h” 11/196 nr. 6398.

⁸⁶ Transmeton Buhariu nr. 1/302, Muslimi 4/2078.

⁸⁷ Transmeton Buhariu 7/167, Muslimi 4/2086.

⁸⁸ Transmeton Hakimi 1/525, i cili e saktëson hadithin, e me të pajtohet edhe Dhehebiu, shiko “El-edhkar” të Neueuiut fq. 340, këtë hadith recenziu Abdulkadër Arnauti e bën të mirë.

⁸⁹ Transmeton Hakimi 1/542, shiko “Sahihul-xhami” 1/396, “Silsiletu ehaditha sahiha” nr. 1539.

⁹⁰ Transmeton Ahmed 4/63, 5/375 shiko “Sahihul-xhami” 1/399

⁹¹ Transmeton Taberaniu, el-Hejthemiu në “Mexhmej zevaid” 10/159 dhe thotë: Burrat e zinxhirit të hadithit janë burra të besueshëm përpos Muhamed ibn Zijeedit i cili është nuk është i besueshëm, shiko “Sahihul-xhami” 1/404

⁹² Transmeton Nesaiu, Ebu Davudi 2/92, shiko “Sahihul-xhami” 3/1123

⁹³ Transmeton Ebu Davudi 2/91, Nesaiu 8/263, Ibn Maxhe shiko “Sahih Nesai” 3/1112

⁹⁴ Transmeton Nesaiu, Ebu Davudi 2/91, shiko “Sahih Nesai” 3/1111, “Sahihul-xhami” 1/407.

⁹⁵ Transmeton Hakimi 1/532, i cili hadithin e saktëson me të pajtohet edhe Dhehebiu, e transmeton po ashtu edhe Nesaiu 8/274, shiko “Sahihul-xhami” 1/408, “Sahihul-xhami” 3/1118.

⁹⁶ Transmeton Tirmidhiu 5/519, Ebu Davudi 2/92, shiko “Sahihul-xhami” 1/410, “Sahihul-xhami” 3/1113

- 88 – *"O Allah ma jep xhenetin dhe më mbroj nga zjarri i xhehenemit"*.⁹⁸ (tri herë)
- 89 – *"O Allah më jep kuptim të fesë"*.⁹⁹
- 90 – *"O Allah më ruaj mos të të bej shirk duke e ditur dhe kërkoi falje nga ajo që e bëj pa dije"*.¹⁰⁰
- 91 – *"O Allah më bën të dobishëm me atë që ma ke mësuar, ma mëso atë që më bën doni dhe ma shto dijen"*.¹⁰¹
- 92 – *"O Allah më jep dije të dobishme, rrisq të mirë, vepër të pranuar"*.¹⁰²
- 93 – *"O Allah të lutem Ty, o Allah i Cili je i Vetmi dhe vetëm i Vetmi, i Panevoj, i Cili nuk ka lindur e as që ka lind dikënd dhe askush nuk është i barabartë me ty, të më falësh mua mëkatet, Ti je Gjithëfalësi, i Gjithëmëshirshmi"*.¹⁰³
- 94 – *"O Allah prej Teje kërkoi ty të takon falenderimi nuk ka zot tjetër përveç Teje (i vetmi, pa rival) Gjithëdhuruesi, o Shpikës i qiejve dhe tokës, o i Lartësuar dhe Bujar, o i Gjallë, o i Përherëshëm, prej Teje kërkoi xhenetin dhe më mbroj nga zjarri"*.¹⁰⁴
- 95 – *"O Allah të lus duke dëshmuar se Ti je Allahu, nuk ka të adhuruar pos Teje, i Vetmi, i Panevoji, i Cili as nuk ka lindur e as ka lindur dikënd, askush nuk i është i barabartë me Të"*.¹⁰⁵
- 96 - *"O Allah më fal mua, ma prano pendimin sepse Ti je Pendimpranues i madh dhe Gjithëfalës"*.¹⁰⁶
- 97 – *"O Allah që në dijen Tënde është e fshehta, fuqia mbi krejt krijesat, më bën të jetoj përderisa jeta që e jetoj është e dobishme për mua, më bën të vdes kur e din se vdekja është më e dobishme për mua, o Allah më jep frikë ndaj Teje haptas dhe fshehtas, kërkoi prej Teje ta them të vërtetën kur jam i hidhëruar dhe i kënaqur, kërkoi mesatari në pasuri dhe varfëri, kërkoi prej Teje begati të pandërprera, prej Teje kërkoi shkëlqim të syve të mij që nuk ndërpritet, prej Teje kërkoi që të jem i kënaqur pas caktimit Tënd, prej Teje kërkoi jetë të freskët pas vdekjes, kërkoi ta shijoj kënaqësinë në shikimin e fytyrës Tënde, përmallim të takimit me Ty, pa kurëfarë pengese, e as pa kurëfarë fitne devijuese, o Allah na zbukuro me bukurinë e imanit dhe na bën udhëzues të udhëzuar"*.¹⁰⁷

⁹⁷ Transmeton Tabraniu, el-Hejthemiu në "Mexhmei zevaid" 11/144 dhe thotë: Burrat e zinxhirit të hadithit janë burra të besueshëm, shiko edhe "Sahihul-xhami" 11/411

⁹⁸ Transmeton Tirmidhiu 4/700, Ibn Maxhe nr. 1453, Nesaiu, shiko "Sahihu Tirmidhiu" 2/319, "Sahihu Nesai" 3/1121 me tekst: *"Kush e lut Allahun tia jep xhenetin tri herë, xheneti thotë: O Allah fute në xhenet ndërsa kush kërkon tri herë mbrojtje nga xhehenemi Allahu ta ruan nga zjarri i xhehenemit, zjarri thotë: O Allah mbrje nga zjarri"*.

⁹⁹ Transmeton Buhariu dhe Muslimi për këtë aludojnë transmetimet e Buhariut dhe Muslimit nga dua ja e të Dërguarit të Allahut-paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, drejtuar Ibn Abasit-Allahu qoftë i kënaqur me të, shiko "El-Buhari meal-fet'h" 1/44, Muslimi 4/1797.

¹⁰⁰ Transmeton Ahmedi 4/403, e të tjerë pos tij, shiko "Sahihu tergib ve terhib" të Albanit 1/19.

¹⁰¹ Transmeton Ibn Maxhe 1/92, shiko "Sahih Ibn Maxhe" 1/47.

¹⁰² Transmeton Ibn Maxhe 1/298, shiko "Sahih Ibn Maxhe" 1/152.

¹⁰³ Transmeton Nesaiu me këtë tekst 3/52, Ahmedi 4/33, shiko "Sahihu Nesai" 1/279.

¹⁰⁴ Transmeton Ebu Davudi 2/80, Ibn Maxhe 2/1268, Nesaiu 3/52, Tirmidhiu 5/650, shiko "Sahihu Nesai" 1/279.

¹⁰⁵ Transmeton Ebu Davudi 2/79, Tirmidhiu 5/515, Ibn Maxhe 2/1267, Ahmedi 5/360, shiko "Sahihu Tirmidhiu" 3/163.

¹⁰⁶ Transmeton Ebu Davudi, Tirmidhiu teksti është i tij, Nesaiu, Ibn Maxhe 2/1353, shiko "Sahihu Ibn Maxhe" 2/321, "Sahihu Tirmidhiu" 3/153

¹⁰⁷ Transmeton Nesaiu 3/54-55, Ahmedi 4/364, me zinxhir të mirë, shiko "Sahihu Nesai" 1/280, 1/281.

98 – “O Allah më dhuro mua dashuri ndaj Teje, dashuri që më bën dobi ta dua tek Ti, o Allah atë dashuri që ma ke dhuruar ma bën forcë për atë që Ti e don, o Allah atë dashuri që kam unë, Ti je Ai që e ke në dorë ma bën atë përfundim që e don Ti”.¹⁰⁸

99 – “O Allah pastrom nga mëkatet dhe gjuhahet, o Allah pastrom nga ata, siç pastrohet rroba e bardhë nga ndytësira, o Allah më pastro me akull, borë dhe ujë të ftohtë”.¹⁰⁹

100 – “O Allah më ruaj nga kopracia, frika nga jeta e keqe, sprova në gjoks dhe nga dënimi i varrit”.¹¹⁰

101 – “O Allah Zoti i Xhibrilit, Mikailit, Zoti i Israfil, më mbro nga nxehtësia e zjarrit të xhehenemit dhe nga dënimi i varrit”.¹¹¹

102 – “O Allah më inspire në udhëzim dhe më ruaj nga sherri i shpirtit tim”.¹¹²

103 – “O Allah më jep dije të dobishme edhe më ruaj nga dituria e padobishme”.¹¹³

104 – “O Allah Zoti i shtatë qiejve, Zoti i tokës, Zoti i arshit të madh, Zoti ynë dhe Zoti i çdo gjëje, çarës i farës dhe i bërthamës, zbritës i Teuratit, inxhilit dhe Furkanit më mbroj nga e keqja e çdo gjëje që ti e ke në dorë, o Allah Ti je i pari nuk ka kush para Teje, ti i fundit nuk ka kush pos Teje, Ti je i dukshmi nuk ka kush më qartë pos Teje, Ti je i brendshmi nuk ka kush tjetër pos Teje, na e kompenzo Ti borxhin tonë dhe na pasuro nga varfëria”.¹¹⁴

105 – “O Allah bashkoi zemrat tona, na prjato neve, na udhëzo në rrugën e drejtë, na nxjerr nga erësira në dritë, na ruaj nga imoraliteti i dukshëm dhe i brendshëm, na beko në dëgjimin tonë, shikimin tonë, zemrat tona, gratë tona, pasardhësit tonë, na e prano pendimin sepse me të vërtet Ti je Pendimpranuesi më i Mëshirshmi, neve na bën falenderues të begative Tua, të të madhërojmë për ta vetëm Ty, pranoi prej neve dhe na i plotëso ata mbi ne”.¹¹⁵

106 – “O Allah të lutem më jep të mirën e lutjes, të mirën e duasë, të mirën e shpëtimit, të mirën e veprës, të mirën e shpërblimit, të mirën e jetës, të mirën e vdekjes, më forco, ma rëndo peshorën time, plotësoje besimin tim, mi ngrit shkallët në xhenet, pranoje namazim tim, mi fal gabimet e mija, prej teje kërkoj gradat më të larta të xhenetit, o Allah më jep mirësitë e fillimit dhe mbarimin e tyre, mirësitë në përgjithësi që nga fillimi qoftë nga jashtë apo nga Brenda si dhe gradat më të larta të xhenetit, o Allah mi jep mirësitë që vijojnë, mirësitë e veprës sime, mirësinë e asaj që do ta bëj, mirësinë e brendshme dhe të jashtme, si dhe gradat më të larta të xhenetit, o Allah ngreje çështjen time, largoj nga unë të këqijat, pastrom mua, na pastro zemrën time, na ruaj organin tim intim, ma ndriço zemrën time, mi fal mëkatet e mia si dhe prej teje kërkoj gradat më të larta në xhenet. O

¹⁰⁸ Transmeton Tirmidhiu 5/523 dhe thotë se hadithi është i mirë, Abdulkadër Arnauti thotë: Dhe ashtu është siç ka thënë ai, shiko recenzimin e tij mbi “Xhamiul-usul” 4/341.

¹⁰⁹ Transmeton Nesaiu 1/198-199, Tirmidhiu 5/515, shiko “Sahihu Nesai” 1/86.

¹¹⁰ Transmeton Nesaiu 8/255, teksti i tij është: i Dërguari i Allahut-paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, kërkonte mbrotje nga pesë gjëra: Kopracia, frika, jeta e keqe, sprova e gjoksit dhe dënimi i varrit. Transmeton Ebu Davudi 2/9, shiko “Xhamiul-usul” me recensim të Arnautit 4/363

¹¹¹ Transmeton Nesaiu 8/278, shiko “Sahihu Nesai” 3/1121

¹¹² Transmeton Ahmedi 4/444, Tirmidhiu dhe teksti është i tij 5/519, zinxhiri i këtij hadithi tek Ahmedi është i mirë.

¹¹³ Transmeton Ibn Maxhe 2/1263, shiko “Sahihu Ibn Maxhe” 2/327, teksti i tij është: “Kërkoni nga Allahu dije të dobishme dhe kërkoni nga Allahu mbrotje nga dija e padobishme”.

¹¹⁴ Transmeton Muslimi 4/2084, nga Ebu Hurejra-Allahu qoftë i kënaqur me të.

¹¹⁵ Transmeton Hakimi dhe thotë: Hadithi është i saktë me kushtet e Muslimit, me të pajtohet edhe Dhehebiu 1/265.

Allah të lus të më bekosh në trupin tim, në dëgjimin tim, shikimin tim, shpirtin tim, në sjelljen time, në pamjen time, në familjen time, në jetën time, në vdekjen time, në veprën time, pranoi veprat e mira të mia si dhe më jep gradat më të larta në xhenet".¹¹⁶

107 – *"O Allah më ruaj nga sjelljet e pahishme, e pshet, veprat dhe sëmundje".¹¹⁷*

108 – *"O Allah më bën të kënaqur me rriskun që ma ke dhënë, më beko në të si dhe më çdo gjë humb ma zavendëso me më të mirë".¹¹⁸*

109 – *"O Allah më llogarit me llogari të lehtë".¹¹⁹*

110 – *"O Allah më ndihmo të të përmendi ty, të të falenderoj ty dhe të të adhuroj Ty sa më mirë".¹²⁰*

111 – *"O Allah më jep besim të paluhatshtëm, begati të pandërprera dhe shoqërim të Muhamedit-paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, në xhenetin e përhershëm".¹²¹*

112 – *"O Allah më mbroj nga e keqja e vetes sime, synoj prej Teje udhëzim në çështjet e mija, o Allah mi fal mua në brendësinë time dhe në shfaqjen time, në atë që haroj dhe në atë që e bëj qëllimisht, atë që e dij dhe atë që nuk e di".¹²²*

113 – *"O Allah më ruaj nga mundja në borxhe, nga mundja e armikut dhe sharja e armiqve mbi ne".¹²³*

114 – *"O Allah më fal mua, më udhëzo, më furnizo, më shpëto, kërkoj mbrojtje o Allah prej Teje prej vendit të ngushtësisë në ditën e gjykimit".¹²⁴*

115 – *"O Allah më kënaq në dëgjimin tim, në shikimin tim, mi trashëgo ata ps meje, më ndihmo, kundër atyre që më bëjnë padrejtësi, hakmeru ti për ne nga ai".¹²⁵*

116 – *"O Allah më jep jetë të pastër, vdekje të mirë si dhe kthim tek ti jo si i poshtëruar dhe i nënçmuar".¹²⁶*

117 – *"O Allah Ty të takon i gjithë falenderimi, o Allah askush nuk mund ta kapë atë që Ti e liron, e askush nuk mund ta liron atë që Ti e kapë, nuk ka udhëzues për atë që Ti e devijon, e as devijues për atë që Ti e udhëzon, nuk mund të jep kush atë që Ti e ndalon, e as ta ndalon kush atë që Ti e jep, nuk mund ta afron dikush atë që Ti largon, e as që mund ta*

¹¹⁶ Transmeton Hakimi nga Umu Seleje-Allahu qoftë i kënaqur me të, si dhe e saktëson hadithin më të pajtohet edhe Dhehebiu 1/520.

¹¹⁷ Transmeton Hakimi dhe thotë se është i saktë në kushtet e Muslimit, me të pajtohet edhe Dhehebiu 1/532

¹¹⁸ Transmeton Hakimi dhe e saktëson me të pajtohet edhe Dhehebiu 1/510 nga Ibn Abasi-Allahu qoftë i kënaqur me të.

¹¹⁹ Transmeton Ahmedi 6/48, Hakimi dhe thotë se është në kushtet e Muslimit, me të pajtohet edhe Dhehebiu 1/255, Aisheja-Allahu qoftë i kënaqur me të, thotë: Pasi u kthye i thashë: O i Dërguari i Allahut e çfarë është llogaria e lehtë? – Më tha: "Të shikon në librin e robit të Tij dhe ta tejkalon atë ndërsa ai cili pyetet në llogari atë ditë oj Aishe do të shkatërohet si dhe çdo gjë që e kaplon besimtarin me të Allahu me të ia shlyen mëkatet qoftë sprovë edhe një ferrë që e shpon.

¹²⁰ Transmeton Hakimi 1/499, i cili e saktëson hadithin me të pajtohet edhe Dhehebiu, Ebu Davudi 2/82, Nesaiu 3/53, ku tregohet se i Dërguari i Allahut-paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, e ka porositur Muadhin-Allahu qoftë i kënaqur me të, ti thotë këto fjalë pas çdo namazi.

¹²¹ Transmeton Ibn Hibani fq. 604 nr. 2436 nga Ibn Mesudi-Allahu qoftë i kënaqur me të, meukufen, Ahmedi me rrugë tjetër 1/386, 400, Nesaiu në "Amelu jeume vel-lejle" nr. 869.

¹²² Transmeton Hakimi 1/510 i cili e saktëson hadithin, me të pajtohet edhe Dhehebiu, Ahmedi 4/444, Hafidhi në "El-isabeh" thotë: Zinxhiri i hadithit është i saktë.

¹²³ Transmeton Nesaiu 8/265, shiko "Sahihu Nesai" 2/1113

¹²⁴ Transmeton Nesaiu 3/209, Ibn Maxhe 1/431, e të tjerë pos këtyre dyve, shiko "Sahihu Nesai" 1/356, "Sahih Ibn Maxhe" 1/226.

¹²⁵ Transmeton Tirmidhiu shiko "Sahihu Tirmidhi" 3/188, Hakimi i cili e saktëson hadithin e më të pajtohet edhe Dhehebiu 1/523.

¹²⁶ "Zevaid musned el-Bezar" 2/442 nr. 2177, Tabraniu shiko "Meaxhmeu zevaid" 10/179 thotë: Zinxhiri i Taberaniut është i mirë.

largon dikush atë që Ti e afron. O Allah lësho mbi ne bekimet tua, mëshirën Tënde, mirësinë Tënde dhe na furnizo, o Allah më jep begati të qëndrueshme të cilat nuk ndrojnë e as nuk humbin, o Allah më jep begati atë ditë kur kam nevojë për to, më siguri në ditën e frikës, o Allah kërkoj mbrojtje prej Teje prej të keqes së asaj që ma ke dhënë dhe prej të keqes së asaj që më ke privuar nga ajo, o Allah na e dashuro neve besimin dhe zbukuroe atë në zemrat tona, na e bën të uryer kufrin, mëkatin gjunahin dhe na bën prej të udhëzuarve, o Allah na vdis neve si musliman, na ngjallë si musliman, na bashko me njerëzit e mirë, mos na turpëro e as mos na sprovo, o Allah vriti pabesimtarët të cilët i përgenjeshtrojnë të Dërguarin Tënd dhe pengojnë nga rruga Yte, mbi ta lësho papastërti dhe dënim, o Allah vriti pabesimtarët të cilët ju erdhi libri, o Allah i vërtet (amin)".¹²⁷

118 – "O Allah më fal mua, më mëshiro, më udhëzo, më jep shëndet e më furnizo".¹²⁸

119 – "O Allah na shto e mos na pakëso, na respekto e mos na nënvlerëso, na jep e mos na privo, na jep për ne, e jo kundra neve, na kënaq neve dhe bëhu Ti i kënaqur me ne".¹²⁹

120 – "O Allah Ti e ke zbukuruar pamjen time ma përmirëso sjelljen time".¹³⁰

121 – "O Allah më forco dhe më bën udhëzues i udhëzuar".¹³¹

122 – "O Allah më jep urtësi, e cila kujt i jepet i është dhënë mirësi e madhe".¹³²

Thotë Allahu: "**Ai ia dhuron hikmetin**¹³³(urtësinë) **atij që do, e kujt i është dhënë hikmeti, i është dhënë mirësi e shumtë, por nuk përkujtohet askush pos të mençurve**".¹³⁴

Si përfundim e lusim Allahun të lëshoj bekimet, lëvdatat e Tij mbi profetin tonë Muhamedin, mbi familjen e tij të ndershëm, mbi shokët e tij besnik dhe mbi gjithë ata që e pasuan, e pasojnë dhe do ta pasojnë rrugën e tij deri në ditën e gjykimit.

¹²⁷ Transmeton Ahmedi ky është teksti i tij 3/424 ndërmjet kllapave është teksti i Hakimit 1/507 3/23-24, po ashtu e transmeton Buhariu në "Edebul-mufred" nr. 699, Albani e saktëson këtë hadith në „Tahrixh fikhu-sire“ fq. 284 si dhe në "Sahih edebul-mufred" të Buhariut nr. 538 fq. 259

¹²⁸ Transmeton Muslimi 4/2072-2073, në një version të sunenit të Ebu Davudit qëndron: Kur u largua beduini, i Dërguari i Allahut-paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, tha: "I mbushi dyert e tij më mirësi".

¹²⁹ Transmeton Tirmidhiu 5/326 nr. 3173, Hakimi 2/98, i cili e saktëson hadithin ndërsa shejh Abdulkadër Arnauti e bën hadithin të mirë në recensimin e tij mbi "Xhamiul-usul" 1/282 nr. 8847.

¹³⁰ Transmeton Ahmedi 6/68, 155, 1/403, Albani e saktëson hadithin në "Irvaul galil" 1/155 nr. 74.

¹³¹ Për këtë aludon dua ja e të Dërguarit të Allahut-paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, drejtuar Xhabirit-Allahu qoftë i kënaqur me të, shiko "El-Buhari meal-fet'h" 6/161.

¹³²

¹³³ Hikme: Letrarisht do të thotë urtësi, por këtu ka kuptim dituri dhe të kuptuarit e Kuranit dhe sunetit si dhe mundësimi i dikujt që të flasë dhe të veprojë në rrugën e drejtë.

¹³⁴ Bekare:269